

## ANEKS 1

### TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR, FORMULA E NDARJES SË FONDEVE, KRITERET DHE KOEFICIENTËT E VITIT 2022

#### 1. Transferta e pakushtëzuar

Transferta e Pakushtëzuar (TP) rregullohet nga Ligji nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili përcakton madhësinë dhe mënyrën e ndarjes për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV). Si rregull i përgjithshëm, transferta e pakushtëzuar ka për qëllim t’u sigurojë njësitë të vetëqeverisjes vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Duke qenë se NJVQV-të janë të ndryshme për sa i përket nevojave dhe kapacitetit fiskal, në një sistem efikas dhe të drejtë të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar duhet të merren parasysh diferencat tek të dy dimensionet.

Për vitin 2022, transfertat në buxhetin e njësitë të vetëqeverisjes vendore janë:

- **Transferta e pakushtëzuar** e cila përbëhet nga:
  - a) **Pjesa e Përgjithshme** prej 18.7 miliard lekë që rezulton nga zbatimi i pikës 2 të nenit 23 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili përcakton se madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 është jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto dhe jo më pak se ajo e vitit 2021; dhe
  - b) **Pjesa Sektoriale** prej 8,75 miliard lekë nga shtesa që rezulton si pasojë e zbatimit të pikës 3 të nenit 95 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për përfundimin e periudhës tranzitore për financimin me transferta specifike të funksioneve të decentralizuara nga ky ligj, dhe zbatimi i pikës 4 të nenit 23 të Ligjit 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” që rregullon konvertimin e transfertave specifike për funksionet e decentralizuara rishtazi në nivel vendor në transfertë të pakushtëzuar sektoriale.

Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2022, që rezulton nga përcaktimi ligjor i madhësisë minimale prej 1% të PBB-së ose prej 18.7 miliard lekë, do të shtohen edhe fondet prej rreth 8,75 miliard lekë, për financimin e funksioneve të reja të cilat për periudhën 2016-2018, janë financuar nëpërmjet transfertave specifike. Nga 1 janari i vitit 2019, transfertat specifike u kthyen në transfertë të pakushtëzuar sektoriale e cila përdoret në autonomi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në total, për vitin 2022, transferta e pakushtëzuar do të jetë 27.45 miliard lekë.

Formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përcaktohet në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Formula identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

## 2. Shuma totale e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022

Në zbatim të pikës 2 dhe 4 të nenit 23 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikës 3 të nenit 95 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, **madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 është 27,45 miliard**, dhe përbëhet nga pjesa e përgjithshme dhe pjesa sektoriale që mbulon funksionet e decentralizuara në vitin 2016.

Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose qark është e barabartë me shumën përkatëse që rezulton nga aplikimi i formulës për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë dhe qarqet sipas parashikimit të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe fondeve të ndara sipas çdo bashkie për funksionet e transferuara (decentralizuara) në vitin 2016.

	<b>TOTALI I TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR (PJESA I + PJESA II)</b>	<b>27,450,000,000</b>
<b>I</b>	<b>Pjesa e Përgjithshme – Ligji për Financat e Vetëqeverisjes Vendore</b>	<b>18,700,000,000</b>
<b>1</b>	<b>Produkti i Brendshëm Bruto i parashikuar për vitin 2021</b>	<b>1,867,351,862,797</b>
<b>2</b>	<b>Transferta e pakushtëzuar për vitin 2022, në % ndaj PBB-së të parashikuar</b>	<b>1%</b>
<b>3</b>	<b>Transferta e Pakushtëzuar për vitin 2022, në Lekë</b>	<b>18,700,000,000</b>
<b>4</b>	<b>Transferta e pakushtëzuar për tu shpërndarë sipas formulës në vitin 2022, pas zbritjes së fondeve si më poshtë:</b>	<b>17,151,942,973</b>
5	<i>Fondi rezervë</i>	<i>100,000,000</i>
6	<i>Fondet për Konviktet dhe Qendrat e Shërbimeve Sociale</i>	<i>594,854,359</i>
7	<i>Fondet për rrugët rurale të transferuara nga Qarqet tek Bashkitë</i>	<i>526,202,668</i>
8	<i>Mbështetje për reformën në financat e arsimit parashkollor</i>	<i>327,000,000</i>
<b>II</b>	<b>Pjesa Sektoriale – Funksionet e Decentralizuara me Ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore”.</b>	<b>8,750,000,000</b>
1	<i>Fondet për personelin mësimor në kopshte në arsimin parashkollor</i>	<i>4,205,238,000</i>
2	<i>Fondet për personelin mbështetës në kopshte dhe arsimin parashkollor</i>	<i>1,135,242,000</i>
3	<i>Fondet për personelin mbështetës në arsimin parauniversitar</i>	<i>520,822,000</i>
4	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e mbrojtjes nga zjarri</i>	<i>1,378,149,000</i>
5	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e administrimit të pyjeve</i>	<i>409,597,000</i>
6	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e ujitjes dhe kullimit</i>	<i>966,310,000</i>
7	<i>Fondet për qendrat e shërbimeve sociale</i>	<i>64,262,000</i>
8	<i>Fondet për rrugët rurale</i>	<i>38,380,000</i>
9	<i>Fondet për klubet shumësportësse “Partizani dhe Studenti”</i>	<i>32,000,000</i>
<b>III</b>	<b>Transferta e pakushtëzuar dhe specifike për tu shpërndarë me formulë në vitin 2022 (I.4+I.8+II.1)</b>	<b>21,684,180,973</b>

Pjesa e Përgjithshme e Transfertës së Pakushtëzuar (TP) për vitin 2022 është 1% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të parashikuar për vitin 2022, ose 18,700,000,000 Lekë, 3 % ose 488.9 milionë lekë më shumë se në vitin 2021. Gjithsej transferta e pakushtëzuar së bashku me specifiken që shpërndahet nëpërmjet formulës është 21,684,180,973 lekë, pas zbritjes së fondeve për konviktet, shërbimet sociale, për rrugët rurale. Deri para vitit 2016, fondet për konviktet, shërbimet sociale dhe për disa kritere të tjera, përfshiheshin në transfertën e pakushtëzuar përfundimtare të bashkive respektive. Me hyrjen në fuqi të formulës së re të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, meqenëse ndarja e fondeve për këto funksione nuk ishte pjesë e formulës, për të rritur transparencën, këto fonde janë nxjerrë jashtë totalit të transfertës që ndahet me formulë. Duke filluar nga viti 2016, këto fonde paraqiten vetëm tek bashkitë përfituese si transfertë e pakushtëzuar, sikurse paraqitur

në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022. Në totalin e transfertës së pakushtëzuar përfshihen edhe fondet për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, që nga 2016 kanë kaluar nga këshillat e qarqeve tek bashkitë. Gjithashtu, fondet për këtë funksion nuk ndahen sipas formulës së transfertës së pakushtëzuar dhe paraqiten të veçanta për bashkitë përfituese në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022.

Në vitin 2022, në zbatim të nenit 28 dhe 37 të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, nenit 23 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 23 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, vazhdon reforma e sistemit të financimit të arsimit parashkollor duke e harmonizuar sistemin me praktikën më të mira ndërkombëtare në financimin e kopshteve. Kjo reformë pritet të sjellë një përmirësim të rëndësishëm në cilësinë e arsimit parashkollor në vendin tonë duke sjellë rritjen e numrit të edukatoreve. Kostoja e reformës është 327 milion lekë dhe do të vazhdojë të mbulohet nga transfertat e pakushtëzuar të vitit 2022.

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Fondet për këto funksione ndahen për çdo funksion dhe për çdo bashki, sipas kriterëve specifikë të përcaktuara në Aneksin nr. 4 dhe në kolonat e veçanta në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse të ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022.

Buxheti i vitit 2022, konfirmon vazhdimin e reformës në arsimin parashkollor. Duke filluar nga viti 2019, dhe në buxhetin e vitit 2022, fondet për arsimin parashkollor ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve me moshë 3-6 vjeç, si treguesi më i mirë i nevojës për shërbim dhe pjesërisht do të bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në 2018. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Kjo reformë siguron një ndarje më të mirë të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t’u ofrohet edukimi parashkollor, por njëkohësisht siguron një tranzicion gradual që minimizon kostot, duke ruajtur 40% të kriterit të skemës së mëparshme. Reforma është plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 28 dhe 37 të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe praktikën e mira ndërkombëtare që rekomandojnë një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Ndryshimi i sistemit të ndarjes së fondeve për arsimin parashkollor në vendin tonë përbën një domosdoshmëri, pasi sistemi aktual nuk reflekton në mënyrë të saktë ndryshimet sociale, demografike dhe infrastrukturore që kanë ndodhur përgjatë më shumë se dy dekadave të fundit. Kjo domosdoshmëri njihet edhe nga legjislacioni aktual për arsimin parauniversitar në Shqipëri, i cili sugjeron një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve.

Kjo reformë siguron:

- Uljen e madhësisë mesatare të grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti mesatar 18 fëmijë për një edukatore (para reformës) në raportin 15 fëmijë për një edukatore.
- Shtimin e fondeve në ato bashki ku ka një nevojë reale për shtimin e numrit të edukatoreve duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 25 fëmijë për një edukatore (para reformës) në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3-6 vjeç që ndjekin kopshtet publike. Shtimi i numrit të edukatoreve nënkupton edhe shtimin e kapaciteteve të shërbimit, duke ulur kështu nevojën për dërgimin e fëmijëve në kopshte private.

- Ruajtjen e fondeve aktuale për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.
- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit fëmijë për edukatore.
- Shtim fondi për stafin mbështetës të arsimit parashkollor.

Kjo reformë, bën një ndarje më të drejtë të fondeve ndërmjet bashkive, zbut diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit "fëmijë për edukatore" dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve.

Në buxhetin e vitit 2022, do të ndahen me formulën e rishikuar të transfertës së pakushtëzuar 21,684,180,973 lekë, e cila përfshin edhe 4,205,238,000 lekë për personelin mësimor në arsimin parashkollor. Fondet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të reja të transferuara në vitin 2016, paraqiten në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022.

### 3. Ndarja e Transfertës së Pakushtëzuar ndërmjet dy niveleve të Qeverisjes Vendore

Për vitin 2022, për financimin e funksioneve të veta Bashkitë marrin 97.5% të totalit të transfertës së pakushtëzuar (të përgjithshme dhe sektoriale) së parashikuar për t'u ndarë me formulë, ose **21,684,180,973 lekë**. Funksionet e reja të transferuara te bashkitë në vitin 2016, financohen nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara sektoriale me kolona të veçanta në tabelën nr.3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022. Fondet për arsimin parashkollor në këtë buxhet janë shpërndarë sipas një formule e cila mbështetet kryesisht në numrin e fëmijëve me moshë 3-6 vjeç.

Ndarja e Transfertës së Pakushtëzuar ndërmjet dy niveleve të Qeverisjes	Në përqindje	Vlera në lekë
Transferta e Pakushtëzuar për Bashkitë	97.4%	21,124,180,973
Transferta e Pakushtëzuar për Qarqet	2.6%	560,000,000

Për vitin 2022, Qarqet marrin **2.5 %** të transfertës së pakushtëzuar ose **560 milion lekë**. Në vijim të transferimit të funksionit të rrugëve rurale nga qarqet tek bashkitë, fondet e shpenzuara nga qarqet për këtë funksion i transferohen bashkive sipas tabelës nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2022.

### 4. Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë

Popullsia është një tregues i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Për rrjedhojë popullsia do të vazhdojë të mbetet kriteri kryesor për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë		30%
Banorë rezidentë efektivë = [CENSUS + (Regjistri i gjendjes civile – Census)*30%]		3,325,359

Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censurit të vitit 2011. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censurit dhe Gjendjes Civile (të vitit 2021) për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore sipas Censurit të vitit 2011 ka 30,000 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile rezultojnë të ketë 45,000

banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë  $30,000 + [(45,000-30,000)*30\%] = 34,500$  banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezulton rreth 3.3 milion banorë, nga 2.8 milion që raportohet nga Censusi dhe 4.5 milion që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censurit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.

## 5. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Bashkitë

Për vitin 2022, transfertat e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë është 21,124,180,973 lekë dhe do të ndahet sipas kriterëve të mëposhtme. Kriteret e shpërndarjes së fondeve në formulë kërkojnë të identifikojnë nevojat reale të shpenzimeve të njësisive të ndryshme të vetëqeverisjes vendore mbi bazën e popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat publike 9-veçare dhe të mesme në territorin e një bashkie.

Në formulë, 61.53% e transfertës për bashkitë alokohet mbi bazën e popullsisë relative. Në vijim të rregullimit të numrit të popullsisë së Censurit duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe të dhënave të Censurit, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr një transfertë të pakushtëzuar prej 3,992 lekë, për çdo banor rezident në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

<b>Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë</b>	<b>21,124,180,973</b>
<b>Komponenti I: Ndarja sipas popullsisë (në përqindje)</b>	<b>62.84%</b>
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	<b>13,273,554,378</b>
Transferta e pakushtëzuar për frymë	<b>3,992</b>

Dendësia e popullsisë është një kriter tjetër që përdoret për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë. Dendësia e popullsisë më e ulët është në bashkitë që përbëhen kryesisht ose plotësisht nga zona rurale dhe/ose malore. Ka një korrelacion të fortë mes njësisive të vetëqeverisjes vendore me dendësi të ulët dhe atyre sipërfaqja e të cilave është mbi 50% malore. Kështu koeficienti, “dendësi e ulët e popullsisë”, çon fonde shtesë në të njëjtin drejtim siç bënte formula e mëparshme e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve shtesë për njësitë vendore malore dhe në vështirësi financiare.

Në formulë 11.78 % e totalit të fondit për bashkitë, ndahet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, e cila ndahet në kufij sipas tabelës së mëposhtme.

<b>Komponenti II: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)</b>	<b>11.78%</b>
<b>Madhësia e Transfertës së Pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë</b>	<b>2,488,791,446</b>
Mesatarja Kombëtare e Dendësisë së Popullsisë	117 banorë/km <sup>2</sup>
Transferta për frymë nga densiteti i popullsisë	2,183 lekë/banorë

Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët e rregullimit	Numri i NJVV-ve përfituese	Dëndësia e popullsisë korresponduese	Popullsia në çdo grup	Popullsia e korrigjuar me koeficientin e rregullimit për çdo grup	Shuma e fondeve shtesë për çdo grup	
Kufiri 1	22%	2.270	10	25.2	114,559	260,049	567,581,431
Kufiri 2	43%	1.669	13	50.4	278,733	465,205	1,015,354,974
Kufiri 3	75%	0.900	10	87.9	347,181	312,463	681,981,072
Kufiri 4	110%	0.350	6	128.9	286,497	100,274	218,857,512
Kufiri 5	>110%	0.001	22	>130.1	2,298,390	2,298	5,016,457
<b>Totali</b>			61		3,325,359	1,140,289	2,488,791,446

Një njësi e vetëqeverisjes vendore me një sipërfaqe të madhe dhe një popullsi më të ulët, nënkupton, për të gjitha kushtet e tjera të barabarta, të ketë kosto më të larta të ofrimit të shërbimeve, rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Për të kompensuar njësitë me dendësi më të ulët për kostot më të larta të shërbimit janë krijuar 5 grupime të njësisve të vetëqeverisjes vendore sipas ngjashmërisë së madhe të dendësisë. Njësitë me dendësi më të ulët popullsie përfitojnë nga koeficientë shtesë më të lartë se ato njësi të cilat kanë një afërsi më të madhe të dendësisë me mesataren kombëtare. Nga ky kriter përfitojnë të gjitha bashkitë, në të cilat banojnë 3,325,359 banorë rezidentë efektivë. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka një dendësi mesatare nën 22% të mesatares kombëtare, ose mesatarisht 26 banorë për km<sup>2</sup>, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me 2.270. Nëse ka një dendësi midis 22% dhe 44% të mesatares kombëtare, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me një koeficient prej 1.669. Pra duke u afruar mesatares kombëtare, koeficientët vijnë duke u zvogëluar. Në përfundim numri i popullsisë për çdo grup dendësie, shumëzohet me koeficientin përkatës dhe transfertën për frymë prej **2,183 lekë** për banorë (që rezulton nga pjesëtimi i shumës prej **2,448,791,446 lekë** me popullsinë totale që rezulton nga aplikimi i koeficientëve për çdo grup).

Kriteri i tretë mbi të cilin ndahet transfertat e pakushtëzuar për bashkitë është numri i fëmijëve në arsimin parashkollor i kombinuar me numrin e personelit mësimor në arsimin parashkollor, dhe numri i nxënësve në shkollat publike nëntë-vjeçare dhe të mesme. Nga viti 2019, dhe në vazhdim formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përditësohet për të akomoduar përfshirjen dhe ndarjen e fondeve për pagat e personelit mësimor në sistemin arsimor parashkollor. Në këtë kuadër, komponenti i arsimit i formulës së transfertës së pakushtëzuar do të ndajë gjithsej 25.38% e totalit të transfertës për tu ndarë me formulë, ose 5,247,835,149 lekë. Nga kjo shumë, 4,419,238,000 lekë janë të dedikuara për pagat e personelit mësimor në arsimin parashkollor. Fondet ndahen 60% mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Në krahasim me vitin 2018 (si vit i fundit i skemës së vjetër), fondet për pagat e personelit mësimor të arsimit parashkollor janë 810 milion lekë ose 18.8% më të larta. Ndërkohë, pjesa prej 5% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për bashkitë, ose 829,597,149 lekë do të ndahet mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike në çdo bashki, kundrejt totalit kombëtar të nxënësve. Bashkitë do të marrin një fond prej 1,917 lekë për çdo nxënës në territorin e tyre.

<b>Komponenti III: Ndarja sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve (në %)</b>	<b>25.38%</b>
<b>Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve, në lek</b>	<b>5,361,835,149</b>
Vlera për personelin mësimor në arsimin parashkollor, në lek	4,532,238,000
Sipas numrit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme	829,597,149

## 6. Ekuilizimi i transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e të ardhurave nga taksat e ndara dhe në raport me transfertën e vitit të mëparshëm

Për të siguruar një ekuilizim horizontal efektiv të transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore në mënyrë që të merren në konsideratë kapacitetet e ndryshme fiskale ndërmjet tyre, në formulë llogaritjet bazohen mbi të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, të cilat mbliidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata qendrore. Ekuilizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme të cilat mbliidhen nga agjenci qendrore dhe u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që të ardhurat që ata mbledhin vetë nuk preken nga sistemi i ekuilizimit duke evituar kështu çdo lloj disincentivimi në mbledhjen e taksave. Në vitin 2020, pjesa e të ardhurave nga këto taksa që u janë transferuar njësive të vetëqeverisjes vendore është 2,696,642,002 lekë, dhe të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), ose mesatarja kombëtare për frymë rezulton 811 lekë për banor, sipas konceptit “banor rezident efektiv”.

<b>Komponenti IV: Sistemi i Ekuilizimit të të ardhurave</b>						
Të ardhurat nga taksat e ndara që do të përdoren për ekuilizimin e të ardhurave (TAP + Taksa e Automjeteve + Taksa mbi transferimin e pasurisë nga personat juridik)						<b>2,696,642,002</b>
Të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), Të ardhura për frymë (TAPF)						<b>811</b>
Nëse NJVV-të kanë TAPF nën	<b>80%</b>	të TAKPF, atëherë ato kompensohen me	<b>100%</b>	të diferencës	Madhësia e ekuilizimit fiskal (fondet që duhet të shtohen)	<b>306,321,168</b>
duke u marrë NJVV-ve me të ardhura për frymë mbi	<b>120%</b>	të mesatares kombëtare (TAKPF)	<b>60%</b>	të difirencës	Fondet që efektivisht shkurtohen	<b>300,378,891</b>
<b>Koeficienti i rishpërndarjes</b>						<b>0.98</b>

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë të ardhura për frymë (TAPF) nën 80% të mesatares kombëtare (TAKPF) prej 811 lekë/frymë, do të kompensohen me 100% të diferencës ndërmjet të ardhurave të tyre për frymë dhe mesatares kombëtare. Kjo llogaritje tregon sa fonde do duhej t’u shtoheshin njësive me të ardhura më të ulta për ti sjellë ato në nivelin prej 649 lekë/frymë (ku  $811 * 80\% = 649$  lekë). Për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më “të ulta” në nivelin prej 80% të mesatares kombëtare, njësive me të ardhura më të larta se 120% e mesatares kombëtare, (pra me TAPF mbi 973 lekë/frymë) do t’u merret 60% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 120% të mesatares kombëtare. P.sh., nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka të ardhura për fryme prej 1200 lekë/frymë, sipas formulës së mësipërme asaj do t’i zbriten 136 lekë/frymë  $[1200 - (120\% * 811)] * 60\% = 136$  lekë/banor. Kjo llogaritje në fund tregon sa janë fondet realisht të disponueshme të cilat mund të transferohen nga njësitë me të ardhura më të larta tek ato më të ultat. Sistemi balancohet automatikisht nëpërmjet një koeficienti të rishpërndarjes i cili përcaktohet nga raporti midis fondeve disponibël për ekuilizim dhe fondeve të nevojshme për ekuilizim. Për vitin 2022, fondet e nevojshme për ekuilizim janë 306,321,168 lekë, ndërkohë që fondet e disponueshme për ekuilizim që vijnë nga

“taksimi” prej 60% të të ardhurave mbi 937 lekë/frymë i njësive me të ardhura më të larta janë 300,378,891 lekë dhe për rrjedhojë koeficienti i rishpërndarjes është 0.98.

## 7. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Qarqet

Qarqeve do t’u ndahen 560 milion lekë, sipas një shume fikse, të barabartë për secilin nga 12 Qarqet, sipas popullsisë rezidente dhe sipas dendësisë së popullsisë në çdo qark kundrejt mesatares kombëtare. Sipas kriterit të parë, 20% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të qarqeve (ose 112 milionë lekë) do të shpërndahet si një shumë fikse prej rreth 9.3 milion lekë për secilin nga 12 Qarqet.

<b>Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet</b>	<b>560,000,000</b>
<b>Komponenti I: Shuma fikse për qarqet (në përqindje)</b>	<b>20%</b>
Transferta e pakushtëzuar për t’u ndarë sipas shumës fikse	112,000,000
Shuma fikse e transfertës së pakushtëzuar për çdo qark	9,333,333

Sipas kriterit të dytë, 50% e transfertës së pakushtëzuar (ose 280 milion lekë) do të ndahet përpjesëtimisht sipas popullsisë rezidente në çdo qark, kundrejt popullsisë totale. Të dhënat për popullsinë e qarqeve ndjekin të njëjtin rregullim të bërë për popullsinë e bashkive.

<b>Komponenti II: Ndarja sipas banorëve rezidentë efektivë (në përqindje)</b>	<b>50%</b>
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	280,000,000
Transferta e pakushtëzuar për frymë (Banorë rezidentë efektivë)	84

Sipas kriterit të tretë, 30% e transfertës së pakushtëzuar (ose 168 milion lekë) do të ndahen mbi bazën e dendësisë së popullsisë në çdo qark, kundrejt dendësisë mesatare kombëtare.

<b>Komponenti III: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)</b>							<b>30%</b>
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							168,000,000
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							117 banorë/km <sup>2</sup>
Transferta për frymë nga komponenti i dendësisë së popullsisë							213 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët	Numri i Qarqeve që përfitojnë	Dendësia e popullsisë për grup	Popullsia për çdo grup	Shuma e shtuar për secilin grup	% e shpërndarjes për grup	
Kufiri 1	<b>90%</b>	<b>0,3</b>	4	105.5	909,635	58,017,864	34%
Kufiri 2	<b>65%</b>	<b>0,5</b>	3	76.2	660,389	70,200,924	42%
Kufiri 3	<b>35%</b>	<b>1,0</b>	2	41.0	187,113	39,781,212	24%
<b>Totali</b>			9		1,757,138	168,000,000	

Qarqet me dendësi më të ulët të popullsisë, duke prezumuar kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve dhe/ose kapacitet fiskal më të ulët, do të përfitojnë fonde shtesë nëpërmjet koeficientëve të përcaktuar më sipër për secilin nga tre grupet. Qarqet janë ndarë në tre grupe të ndryshëm sipas raportit mes dendësisë së tyre të popullsisë dhe mesatares kombëtare. Kufijtë e ndarjes së grupeve ndjekin ngjashmërinë e raportit të dendësisë ndaj mesatares kombëtare. Kështu, nëse një Qark ka një dendësi të popullsisë nën 35% të mesatares kombëtare, që nënkupton mesatarisht më pak se 41 banorë për km<sup>2</sup>, kundrejt mesatares kombëtare prej 117 banorë për km<sup>2</sup>, dhe një popullsi prej 93,225 banorësh rezidentë, atëherë popullsia e atij qarku shumëzohet me koeficientin shtesë përkatës (+1) dhe transfertën për frymë prej 213 lekë për banor, duke rezultuar në një shtesë fondesh prej 19,856,925 lekë (i llogaritur në këtë mënyrë:  $93,225 * 1 * 213$ ).